



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

Olimpiada e gjuhës shqipe dhe e letërsisë

Faza II

Viti shkollor 2014-2015

Klasa 11

8 prill 2015

Kjo skemë vlerësimi është orientuese.

Përgjigjet e nxënësve do të vlerësohen duke u bazuar në kriteret e dhëna më poshtë. Secili kriter ka një total pikësh. Nxënësi duhet të shfaqë disa kompetenca për secilin kriter, të cilat qartësohen në tabelën përkatëse. Kjo tabelë shpreh në mënyrë të detajuar se çfarë duhet të përmbushë nxënësi për të marrë pikë të plota apo ndërmjetëse.

1.

Titulli është i rëndësishëm për pjesën letrare.

Duke iu referuar një ose më shume veprave që keni studiuar, analizoni vlerën e këtij pohimi.

20 pikë

Rubrikat e vlerësimit

I. Kuptimi dhe zhvillimi: përgjigja e dhënë dëshmon se nxënësi e ka kuptuar pyetjen dhe përmes interpretimeve dhe analizave që ai zhvillon (në tekstin ose tekstet e marra në shqyrtim).
-Zhvillon idetë, duke përdorur detaje specifike të përzgjedhura me shumë kujdes.

5 pikë

II. Organizimi: përgjigja shfaqet e orientuar, organizuar dhe koherente.

5 pikë

III. Përdorimi gjuhësor: përgjigja e dhënë shfaq qartë qëllimi dhe ndjeshmëri ndaj audiencës (së cilës i drejtohet) dhe për t'ia arritur kësaj përdor në mënyrë efektive fjalët dhe fjali të shumëllojshme (në formë dhe përmbajtje).

5 pikë

IV. Saktësia gjuhësore: përgjigja e dhënë respekton rregullat e drejtshkrimit, shenjave të pikësimit dhe shkronjës së madhe.

5 pikë

Kriteret	5 Përgjigja në këtë nivel:	4 Përgjigja në këtë nivel:	3 Përgjigja në këtë nivel:	2 Përgjigja në këtë nivel:	1 Përgjigja në këtë nivel:
I. Kuptimi dhe zhvillimi	<p>-jep një interpretim që i qëndron besnik kompleksitetit të përmbajtjes së pyetjes dhe përcakton qartë kriteret e analizës.</p> <p>-i përdor kriteret për të zhvilluar një analizë të thellë në shembujt që përdor (nga tekstet etj).</p> <p>-zhvillon qartësisht dhe me saktësi idenë e vet, duke përdorur në mënyrë efektive një gamë të gjerë të dhënash specifike dhe elementesh letrare nga veprat e përzgjedhura apo shembuj të tjerë.</p>	<p>-jep një interpretim të mirë dhe përcakton qartë kriteret e analizës.</p> <p>-i përdor kriteret për të zhvilluar një analizë të thellë në shembujt që përdor (nga tekstet etj).</p> <p>-zhvillon idetë qartësisht dhe në mënyrë të vazhdueshme, duke përdorur referencat e duhura dhe elementet letrare nga veprat e marra në shqyrtim.</p>	<p>-shfaq një interpretim të arsyeshëm të kërkesës që shtron pyetja.</p> <p>-bën një lidhje të nënkuptuar midis kriterëve dhe teksteve të përzgjedhura.</p> <p>-zhvillon disa ide më mirë se disa të tjera, duke përdorur referencat e duhura dhe elementet letrare nga veprat e marra në shqyrtim.</p>	<p>-shfaq një interpretim konfuz apo jo të plotë.</p> <p>-përdor tërthorazi ndonjë kriter analize, por nuk e përdor në tekstet e zgjedhura.</p> <p>-janë të paplota apo të pazhvilluara, ide të paqarta. Referencat ndaj tekstit të marrë si shembull janë të mjegullta, të pavend, përsëritëse apo të pajustificuara.</p>	<p>-nuk i referohet pyetjes.</p> <p>-reflekton pak ose aspak përpjekje për të analizuar tekstet e marra si shembull.</p> <p>-është minimale, e pazhvilluar.</p>
II. Organizimi	<p>- zhvillon një organizim shumë të mirë, të fokusuar në atë çfarë kërkon pyetja.</p> <p>-krijon një strukturë koherente dhe logjike, përmes përdorimit të mjeteve të duhura gjuhësore.</p>	<p>-ruan fokusin në atë çfarë kërkon pyetja.</p> <p>-shfaq sekuenca logjike të ideve, përmes përdorimit të mjeteve të duhura.</p>	<p>-ruan një fokus të qartë dhe të duhur.</p> <p>-shfaq sekuenca logjike të ideve por mund të humbasë qëndrueshmërinë e brendshme (koherencën)</p>	<p>-i mungon fokusi i duhur por shfaq një lloj organizimi. Ose</p> <p>-sugjeron fokus por i mungon organizimi.</p>	<p>-nuk ka as fokus dhe as organizim.</p>
	- përdor	-përdor disa	-shfaq kontroll	-shfaq kontroll	-ka një

<p>III. Përdorimi gjuhësor</p>	<p>shumëllojshmëri fjalish dhe shfaq një përzgjedhje shumë të mirë të fjalëve.</p>	<p>fjali të ndryshme dhe një përzgjedhje të mirë të fjalëve.</p>	<p>mbi përzgjedhjen e fjalive, por këto janë të thjeshta dhe jo të larmishme.</p>	<p>të pamjaftueshëm kur kalon nga një fjali në tjetrën; mund të përzgjedhë fjalë të palidhura nga ana kuptimore.</p>	<p>kontroll minimal ose jo kur kalon nga një fjali në tjetrën. Përzgjedhja e fjalëve mund të jetë e pasaktë në një pjesë ose në të gjithë përgjigjen.</p>
<p>IV. Saktësia gjuhësore</p>	<p>-ka shumë pak ose aspak gabime në gramatikë, drejtshkrim dhe shenja pikësimi, të cilat nuk ndikojnë në përgjigjen që ka dhënë.</p>	<p>-ka pak gabime në gramatikë, drejtshkrim dhe shenja pikësimi, të cilat nuk ndikojnë në përgjigjen që ka dhënë.</p>	<p>-ka pak gabime në gramatikë, drejtshkrim dhe shenja pikësimi, të cilat nuk ndikojnë në përgjigjen që ka dhënë.</p>	<p>-ka gabime në gramatikë, drejtshkrim dhe shenja pikësimi (mungesa fjalësh, fjalë të shkruara gabim, përdorimi i gabuar i fjalëve ose i rendit të tyre), të cilat ndikojnë deri diku në përgjigjen që ka dhënë.</p>	<p>-ka shumë gabime në gramatikë, drejtshkrim dhe shenja pikësimi (mungesa fjalësh, fjalë të shkruara gabim, përdorimi i gabuar i fjalëve ose i rendit të tyre), të cilat ndikojnë në përgjigjen që ka dhënë.</p>

2.

Imagjinoni sikur jeni pranë liqenit dhe shikoni se po afron stuhia.

Përshkruajeni atë. Përdorni një gjuhë të gjallë dhe fjali të llojeve të ndryshme.

15 pikë

Rubrikat e vlerësimit

I. Kuptimi dhe zhvillimi: përgjigja e dhënë dëshmon se nxënësi e ka kuptuar pyetjen dhe krijon një histori (ngjarje), ku vendin kryesor e zë përfytyrimi dhe imagjinata.

3 pikë

II. Zhvillimi i ideve: përgjigja e dhënë përdorur detaje specifike, imazhe dhe figura mbresëlënëse të përzgjedhura me shumë kujdes.

3 pikë

III. Organizimi: përgjigja shfaqet e orientuar, organizuar dhe koherente.

3 pikë

IV. Përdorimi gjuhësor: përgjigja e dhënë shfaq qartë qëllimi dhe ndjeshmëri ndaj audiencës (së cilës i drejtohet) dhe për t'ia arritur kësaj përdor në mënyrë efektive fjalët dhe fjali të shumëllojshme (në formë dhe përmbajtje).

3 pikë

V. Saktësia gjuhësore: përgjigja e dhënë respekton rregullat gjuhësore.

3 pikë

Kriteret	3 Përgjigjja në këtë nivel:	2 Përgjigjja në këtë nivel:	1 Përgjigjja në këtë nivel:
I. Kuptimi	-shfaq një histori të qartë, detaje të zgjedhura me shumë kujdes, përfytyrime dhe imazhe mbresëlënëse.	- krijon një histori me pak detaje dhe imazhe.	- përpiqet t'i përgjigjet pyetjes, por jep pak informacion. -shpesh ripërsërit pyetjen.
II. Zhvillimi	-zhvillon qartësisht dhe me saktësi historinë e vet, duke përdorur në mënyrë efektive detaje përshkruese, tepër të gjetura.	-zhvillon shkurt disa përshkrime -mund të bazohet kryesisht në detaje dhe imazhe të thjeshta.	-ka ide të pazhvilluara, jo të qarta, përshkrime jo të duhura, përsëritje të shumta dhe të pajustificuara.
III. Organizimi	-zhvillon një organizim shumë të mirë, të fokusuar në atë çfarë kërkon pyetja. -krijon një strukturë koherente dhe logjike, përmes përdorimit të mjeteve të duhura gjuhësore.	-shfaq mungesë organizimi dhe fokusi. Idetë nuk lidhen me njëra-tjetrën.	-është e paorganizuar. Idetë lidhen pa asnjë qëllim dhe përgjigjja është shumë e shkurtër për të pasur një organizim.
IV. Përdorimi gjuhësor	-është e sofistikuar nga pikëpamja stilistikë, duke përdorur një gjuhë që është e saktë dhe tërheqëse, me një ndjeshmëri të dukshme ndaj qëllimit dhe audiencës që mendohet se i drejtohet. - ka fjali që variojnë në strukturë dhe gjatësi, për të përforcuar kuptimin.	Bazohet në fjalorin bazë, duke e mos e pasur të qartë audiencën së cilës i drejtohet. -shfaq disa përpjekje për të përdorur fjali që variojnë në strukturë apo gjatësi, por pa arritur ndonjë rezultat të dukshëm.	-përdor një gjuhë që është e papërshtatshme apo e pasaktë për qëllimin apo audiencën. -shfaq pak njohuri mbi mënyrën se si duhen përdorur fjalitë për të arritur një efekt të caktuar.
V. Saktësia gjuhësore	-demonstron kontroll të gjuhës. Ka shumë pak ose aspak gabime në gramatikë, drejtshkrim dhe shenja pikësimi, të cilat nuk ndikojnë në përgjigjen që ka dhënë.	-ka pak gabime në gramatikë, drejtshkrim dhe shenja pikësimi, të cilat nuk ndikojnë në përgjigjen që ka dhënë.	-shfaq shumë gabime në gramatikë, drejtshkrim dhe shenja pikësimi (mungesa fjalësh, fjalë të shkruara gabim, përdorimi i gabuar i fjalëve ose i rendit të tyre), të cilat ndikojnë në përgjigjen që ka dhënë.

3.

Shpesh të rriturit shqetësohen për përmbajtjen e teksteve muzikore që dëgjojnë të rinjtë.

A mendoni se ata vërtetë duhet të shqetësohen për këtë?

Shkruani një letër bindëse ku të pohoni dhe të mbroni pozicionin tuaj.

(Kujdes, mos shkruani emrin tuaj në fund të letrës.)

15 pikë

Rubrikat e vlerësimi

- I. Kuptimi dhe zhvillimi:** përgjigjja e dhënë dëshmon se nxënësi e ka kuptuar pyetjen dhe përmes interpretimeve dhe analizave që ai zhvillon (në tekstin ose tekstet e këngëve të marra në shqyrtim). **3 pikë**
- II. Zhvillimi:** përgjigjja e dhënë përdor detaje specifike të përzgjedhura me shumë kujdes nga teksti ose tekstet e marra në shqyrtim. **3 pikë**
- III. Organizimi:** përgjigjja shfaqet e orientuar, organizuar dhe koherente. **3 pikë**
- IV. Përdorimi gjuhësor:** përgjigjja e dhënë shfaq qartë qëllimi dhe ndjeshmëri ndaj audiencës (së cilës i drejtohet) dhe për t'ia arritur kësaj përdor në mënyrë efektive fjalët dhe fjali të shumëllojshme (në formë dhe përmbajtje). **3 pikë**
- V. Saktësia gjuhësore:** përgjigjja e dhënë respekton rregullat gjuhësore. **3 pikë**

Kriteret	3 Përgjigja në këtë nivel:	2 Përgjigja në këtë nivel:	1 Përgjigja në këtë nivel:
I. Kuptimi	-jep një shpjegim që i qëndron besnik kompleksitetit të përmbajtjes së pyetjes dhe përcakton qartë kriteret e interpretimit dhe të argumentimit. -i përdor argumentet për të zhvilluar një analizë të thellë në shembujt që përdor (nga tekste këngësh etj).	-jep një shpjegim të thjeshtë të përmbajtjes së pyetjes dhe sugjeron një ose disa argumente në përpjekje për të mbrojtur pozicionin e vet. -bën një lidhje sipërfaqësore midis teksteve të këngëve dhe idesë që përpiket të mbrojtë.	-jep një shpjegim konfuz ose të paqartë. Përpiket, por nuk ka asnjë kriter për të mbrojtur qëndrimin e tij përmes shembujve të zgjedhur.
II. Zhvillimi	-zhvillon qartësisht dhe me saktësi idenë e vet, duke përdorur në mënyrë efektive një gamë të gjerë të dhënash specifike nga shembujt e përzgjedhur.	-zhvillon shkurt disa ide duke përdorur shembuj apo referenca të ndryshme. -mund të bazohet kryesisht në përmbledhjen e një apo disa tekstesh këngësh, që ka marrë si shembull.	-ka ide të pazhvilluara, jo të qarta, referenca jo të duhura, përsëritje të shumta dhe të pajustificuara.
III. Organizimi	-zhvillon një organizim shumë të mirë, të fokusuar në atë çfarë kërkon pyetja. -krijon një strukturë letre, koherente dhe logjike, përmes përdorimit të mjeteve të duhura gjuhësore.	-shfaq mungesë organizimi dhe fokusi. Idetë nuk lidhen me njëra-tjetrën.	-është e paorganizuar. Idetë lidhen pa asnjë qëllim dhe përgjigja është shumë e shkurtër për të pasur një organizim.
IV. Përdorimi gjuhësor	-është e sofistikuar nga pikëpamja stilistikë, duke përdorur një gjuhë që është e saktë dhe tërheqëse, me një ndjeshmëri të dukshme ndaj qëllimit dhe audiencës që mendohet se i drejtohet. - ka fjali që variojnë në strukturë dhe gjatësi, për të përforcuar kuptimin.	- bazohet në fjalorin bazë, duke e mos e pasur të qartë audiencën së cilës i drejtohet. -shfaq disa përpjekje për të përdorur fjali që variojnë në strukturë apo gjatësi, por pa arritur ndonjë rezultat të dukshëm.	-përdor një gjuhë që është e papërshtatshme apo e pasaktë për qëllimin apo audiencën. -shfaq pak njohuri mbi mënyrën se si duhen përdorur fjalitë për të arritur një efekt të caktuar.
V. Saktësia gjuhësore	-demonstron kontroll të gjuhës. Ka shumë pak ose aspak gabime në gramatikë, drejtshkrim dhe shenja pikësimi, të cilat nuk ndikojnë në përgjigjen që ka dhënë.	-ka pak gabime në gramatikë, drejtshkrim dhe shenja pikësimi, të cilat nuk ndikojnë në përgjigjen që ka dhënë.	-shfaq shumë gabime në gramatikë, drejtshkrim dhe shenja pikësimi (mungesa fjalësh, fjalë të shkruara gabim, përdorimi i gabuar i fjalëve ose i rendit të tyre), të cilat ndikojnë në përgjigjen që ka dhënë.